

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT


SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS


POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU


Në padinë e

ASC-10- 0006


Paditësit/Ankuesit











A horizontal bar chart consisting of six solid black bars of different widths. The bars are arranged horizontally from left to right, with their lengths decreasing sequentially. They are set against a white background with a thin, light gray horizontal line serving as a baseline.

të gjithë (1 deri 162) të përfaqësuar nga Kryetari i Sindikatës [REDAKTUE], rruga
[REDAKTUE], Prishtinë

Term	Percentage (%)
BlackBerry	92
Facebook	88
Twitter	85
YouTube	82
Skype	78
LinkedIn	75
Spotify	72
Instagram	68
Dropbox	65
Tumblr	62
Twitter	60
Twitter	58
Twitter	55
Twitter	52
Twitter	50
Twitter	48

vs.

NSH Prishtinë

E Paditura

Përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
vetë e përfaqësuar nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut,
Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Tapio Vanamo, Kryetar i DHPGJS-së, Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësve kundër aktvendimit të Trupit Gjyques të DHPGJS-së së datës 17 dhjetor 2009, SCC-07-0245, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 10 shkurt 2011 lëshon këtë

AKTVENDIM

1. Ankesa e Ankuesve 1-162 refuzohet si e pa bazuar.
2. Ankesa e Ankuesve 163-2020 hedhet poshtë si e papranueshme.
3. Vërtetohet aktvendimi i Trupit Gjykues i datës 17 Dhjetor 2009, SCC-07-0245.
4. Në rastin e ankesës, pika 2 e dispozitivit të aktvendimit të Trupit Gjykues të datës 17 dhjetor 2009, SCC-07-0245, eliminohet.
5. Në rastin e ankesës, AKM-ja hiqet nga lënda si e Paditur.
6. Obligohen ankuesit që bashkërisht të paguajnë taksat gjyqësore prej 60 euro për procedurën ankimore në DHPGJS..

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 4 qershor 2007 Paditësit kanë ushtruar padi pranë DHPGJS-së, me të cilën kanë kërkuar që të obligohet i Padituri t'u paguajë atyre pagat për periudhën 1991 deri më 1999, duke përfshirë kamatën ligjore si dhe kompensimin për shpenzimet procedurale. Si të Paditur ata e paraqitën "Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit lidhur me NSH [REDACTED]" në Prishtinë".

Me aktvendimin e Trupit Gjykues të datës 17 Dhjetor 2009, SCC-07-245, DHPGJS-ja e pezulloi lëndën në bazë të nenit 9.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18, duke argumentuar se Agjencia e ka iniciuar likuidimin e të Paditurit të dytë NSH [REDACTED] në Prishtinë me efekt nga data 13 Prill 2007. Trupi Gjykues në aktvendimin e tij i paraqiti si të Paditur NSH-në në fjalë si dhe AKM-në.

Aktvendimi i ankimuar i është dorëzuar përfaqësuesit të paditësve, Azem Berishës më 19 Dhjetor 2009, i cili më 12.01.2010, në emër të të gjithë Paditësve ka dorëzuar ankesën kundër aktvendimit.

Më 08 shkurt 2010 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi nga Ankuesit që në afatin prej 20 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit të dorëzojnë autorizimin ligjor të nënshkruar nga të gjithë Ankuesit, përfshirë një autorizim të posaçëm për procedurën ankimore para Kolegit të Ankesave si dhe një përkthim në gjuhën angleze të këtij dokumenti.

Urdhri i është dorëzuar përfaqësuesve të Ankuesve më 11 shkurt 2010, dhe ai këtij urdhri i është përgjigjur më 02 mars 2010, duke dorëzuar autorizimet e veçanta ligjore për të 162 Ankuesit dhe duke theksuar se për pjesën tjetër të ankuesve nuk ishte në gjendje të ofronte dokumentet e tillë pasi që disa prej tyre kanë vdekur, disa kanë ndërruar vendbanimin dhe adresën, ndërsa një numër prej tyre kanë emigruar në botën e jashtme.

Me urdhrin e datës 04 shkurt 2010 Kolegji i Ankesave dërgoi ankesën me dokumentet mbështetëse tek NSH-ja e paditur, gjoja të përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si dhe tek AKM-ja, duke iu dhënë atyre mundësinë që të ushtrojnë përgjigje në ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit.

Më 08 mars 2010 AKP-ja ushtroi përgjigje në ankesë me të cilën kundërshtoi meritat e padisë.

Më 26 mars 2010 Kolegji i Ankesave lëshoi një urdhër me të cilin kërkoi sqarime nga, që të dyja, AKM-ja dhe AKP-ja rrëth njoftimit të bërë për Ankuesit procedurën e likuidimit, për emërimin e komisionit të likuidimit dhe për atë nëse Ankuesit kishin bërë ankesë para komisionit të likuidimit.

Në përgjigjen e saj AKP-ja paraqet se njoftimi i likuidimit ishte dhënë në gazeta dhe shpreh mendimin e saj se dita e publikimit llogaritet si dita e njoftimit për paditësit. Komisioni i likuidimit ishte krijuar më 13 Prill 2007, dhe vetëm disa prej Ankuesve kishin bërë ankesë para komisionit të likuidimit.

AKM-ja në përgjigjen e sj shpreh pendimin se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme duke marrë parasysh se Ankuesit nuk kishin identifikuar të Paditurin e saktë, që do të thotë AKM-në (në vend se të adresonin AKP-në e cila nuk ishte pjesë e procedurës para Trupit Gjyques).

Arsyet Ligjore:

1. Para se të vendosë për pranueshmërinë e ankesës apo të kalojë tek meritat e saj, Kolegji i Ankesave duhet të sqarojë çështjen në vijim: Është e paqartë për Kolegjin e Ankesave, pse Trupi Gjyques *ex officio* e paraqiti AKM-në si të Paditur. Qëllimi i Paditësit ishte i qartë për të paditur NSH-në, kontraktonin e tyre, të paktën në kohën e dorëzimit të padisë të përfaqësuar nga AKM-ja, por jo të padiste vet AKM-në, pasi që është e qartë se AKM-ja nuk ka *legitimatio passiva* në këtë lëndë, pasi që nuk kishte marrëdhënie kontraktuese mes Paditësve dhe AKM-së dhe pasi që Paditësit, po ashtu, kurrë nuk pretenduar për marrëdhënie të tilla e as ndonjë bazë tjetër ligjore për çfarëdo padi kundër AKM-së si e tillë.

Si e tillë, duhet të theksohet se "përfshirja" e thjeshtë e një pale tjetër si i Paditur, pa e zgjeruar Paditësi(t) padinë tek të Paditurit tjerë, në përgjithësi është pa ndonjë lidhje përkatëse, dhe pa ndonjë ndikim në "palën" pra (në mënyrë të hollësishme apo të nënkuptuar) të ftuar në gjykim (krahaso ASC-09-0029, ASC-09-0035, ASC-10-0022, ASC-09-0004 et al.). Ky është një nga parimet themelore të procedurës civile (të paktën në kontekst të Evropës kontinentale) që i mbetet ekskluzivisht Paditësit se kundër kujt dëshiron të nisë procedurën, e jo Gjykatës. Për këtë arsy, aktvendimi i Trupit Gjyques duhet të korrigohet në këtë masë, pasi që i vetmi i Paditur është NSH [REDACTED] Prishtinë.

Sa i përket çështjes se cila prej dy Agjencive që ka dorëzuar përgjigje në ankesë ka të drejtën të përfaqësojë të Paditurin dhe kështu duhet të paraqitet (dhe t'i dërgohet aktvendimi) si përfaqësuese e të Paditurit, duhet të theksohet se kjo çështje, sa i përket mungesës së arritjes të padisë si e tillë,

nuk ka ndonjë rëndësi të vërtetë për rezultatin e këtyre procedurave. Megjithatë, paraqitja e përfaqësuesit në lëndën në fjalë i respekton udhëzimet e krijuara nga Kolegji i Ankesave në aktvendimin e tij ASC-09-0025 të datës 24 korrik 2010.

2. Ankesa është pjesërisht e papranueshme dhe pjesërisht e pranueshme, por e pabazuar.

a. Sa u përket Ankuesve 163 deri 202, ankesa është e papranueshme. Përfaqësuesi i pretenduar i Ankuesve nuk i ka ofruar Kolegjet të Ankesave autorizimin ligjor të kërkuar. Sipas neneve 61.4, 58.2, 28.2 lit.f dhe 25.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Pasi që ankesa nuk ishte nënshkruar nga një përfaqësues i mirëfilltë i autorizuar i Ankuesve 163 deri 202, nuk e bartë nënshkrimin e nevojshëm sipas nenit 25.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6.

b. Sa u përket Ankuesve 1 deri 162, ankesa është e pranueshme, por e pabazuar.

Saktësisht Trupi Gjykues e pezulloi procedurën për shkak të likuidimit në vazhdim të të Paditurit.

Sic është cituar nga Trupi Gjykues, nisi 9.3 i RREG UNMIK-ut 2002/12, i ndryshuar me RREG UNMIK-ut 2005/18, thotë:

"9.3 Çfarëdo padie gjyqësore kundër ndërmarrjes në pronësi shoqërore që i nënshtronhet likuidimit sipas këtij nisi, pezullohet me rastin e paraqitjes së kërkesës nga Agjencia në gjykatën e vendit ku është paraqitur padia. Kërkesës së tillë i duhet bashkëngjitur:

(a) Dëshmia për dorëzimin e njoftimit, të përshkruar në nenin 39.3 të Rregullores mbi Organizatat e Biznesit (kur objekt i procedimit të likuidimit është korporata); (b) Dëshmia për publikimin e informatave të përfshira në atë njoftim, në një publikim kryesor në gjuhën shqipe, që ka tirazh të gjerë në Kosovë, një herë në javë për dy

javë rresht dhe në një publikim kryesor në gjuhën serbe, në pajtim me kriteret që cakton Bordi;

(c) Dëshmia për paraqitjen në faqen e internetit të Agjencisë në faqen e internetit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, nëse ekziston faqja e internetit në kohën e likuidimit; dhe

(d) Dëshmia për njoftimin e subjekteve për të cilat Agjencia beson, ose ka arsyé për të besuar, se kanë pretendim ndaj ndërmarrjes përkatëse në pronësi shoqërore.”

Gjithashtu, neni 13.1 i UA-së së UNMIK-ut 2007/1 mbi zbatimin e RREG UNMIK-ut 2005/48 për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe pasurisë së tyre me Autorizimin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit parasheh se njoftimi i shoqëruar me dëshmitë e kërkua ka efektin e moratoriumit siç parashihet në nenin 5.1 të RREG UNMIK-ut 2005/48.

Njoftimi i AKM-së i pranuar nga DHPGJS-ja më 6 qershor 2007 lidhur me nisjen e procedurës së likuidimit të të Paditurit me efekt nga data 13 Prill 2007, i plotëson kriteret e paraqitura në dispozitën e cituar. Në veçanti, lista e Paditësve që janë njoftuar direkt nga AKM-ja përfshin Ankuesit.

Nën këto rrethana pezullimi i lëndës, siç është vendosur nga Trupi Gjykues, ishte përfundim i detyrueshëm, dhe nuk do të mund të merrej asnjë vendim tjetër.

Me paraqitjen e kérkesës për pezullimin e procedurës, Gjykata ex lege është e detyruar që menjëherë të pezullon procedurën gjyqësore.

Trupi Gjykues me aktvendimin e ankimuar në mënyrë të drejtë i ka udhëzuar Ankuesit që të paraqiten me padë para komisionit të likuidimit i cili, në raste të këtilla, është organi i vetëm ligjor për shqyrtimin e kérkesave të kreditorëve potencial ndaj të Paditurit. Kështu Paditësit mund të realizojnë kérkesat e veta pranë komisionit të likuidimit të krijuar nga Agjencia.

3. Pika 2 e dispozitivit të aktvendimit të ankimuar duhet të hiqet në rastin e ankesës pasi që udhëzimet për të ushtruar ankesë duke cituar ligjin, pa ndonjë liri veprimi nga ana e gjykatës, janë që të mos merret asnjë vendim në dispozitiv. Informacionet e tilla mund të jepen me arsyé ligjore ose – më mirë – të bashkëngjiten vetëm në aktvendim.

4. Sipas nenit 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe nenit 66 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Trupi Gjykues merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës gjyqësore në shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore në të dyja shkallët.

Taksat Gjyqësore të përcaktuara me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02, i aprovuar më 27.11.2008 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, janë të aplikueshme edhe për procedurat gjyqësore pranë DHPGJS-së, në bazë të Rregullave Plotësuese Procedurale që janë (ri)nxjerrë nga Kryetari i DHPGJS-së më 13 dhjetor 2010.

Bazuar në nenin 10.11, tarifa e taksës gjyqësore për ushtrimin e ankesës është 30 euro, ndërsa në bazë të nenit 10.21 lidhur me 10.1 të Udhëzimit të cekur Administrativ, tarifa për aktvendim në shkallë të dytë është 30 euro.

Bazuar në dispozitat e cekura të këtij Udhëzimi Administrativ, Ankuesit bashkërisht duhet t'i paguajnë Dhomës së Posaçme 60 euro .Për më shumë informata rrëth aspektit të taksave gjyqësore (shih ASC-09-0021, ASC-10-30, ASC-10-0009 etj).

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së më 10 shkurt 2011:

Tapio Vanamo, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it

Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar

Tobias Lapke, Registrues i EULEX-it